

## RAPORTI I PËRKOHSHËM 10 – 26 Mars

31 Mars

### I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Zgjedhjet presidenciale do të mbahen më 13 prill, me rrethin e dytë të mundshëm më 27 prill. Pas mospajtimit mes dy partive të koalicionit qeverisës për propozimin e një kandidati presidencial konsensual, parlamenti është shpërndarë më 5 mars dhe janë shpallur zgjedhje të parakohshme për 27 prill.
- Amendamentet e janarit të Kodit zgjedhor janë përpjekje për trajtimin e shumicës së rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, mbeten disa çështje shqetësuese të cilat nuk janë trajtuar, përfshirë pabarazinë e votave në vend dhe atyre jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare, si dhe kërkesa për dalje prej 40% në rrethin e dytë zgjedhor të zgjedhjeve presidenciale.
- Administrata zgjedhore e përbërë prej tre niveleve, nën udhëheqjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), i ka përbushur të gjitha afatet ligjore të deritashme, marrë në përgjithësi. Sesionet e KSHZ-së të cilat janë vijuar nga MVZ i OSBE/ODIHR janë realizuar në mënyrë profesionale dhe procesverbalet për çdo sesion janë publikuar në ueb-faqen e KSHZ-së. Në disa raste, anëtarët kanë votuar përgjatë linjave partiake, duke krijuar tension.
- Në zgjedhjet presidenciale do të garojnë katër kandidatë. Afati për parashtrimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare është përcaktuar për 29 mars.
- Fushata zgjedhore për zgjedhjet presidenciale ka filluar zyrtarisht më 24 mars, ndërsa fushata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare fillon më 5 prill. Kandidatët presidencialë kanë filluar me promovimin e kandidaturave gjatë vizitave anembanë vendit edhe para kësaj date. KSHZ ka shqyrtuar dy kundërshtime të parashtruara nga Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM), e cila ka pretenduar për fillim të parakohshëm të fushatës. KSHZ e ka pranuar kundërshtimin e parë dhe e ka hedhur poshtë tjetrin.
- Fillimi i fushatës është shënuar me retorikë ndarëse etnike. Kryeministri i ka bërë thirrje maqedonasve etnikë t'i japin VMRO-DPMNE-së shumicë të qartë prej 62 deputetëve, për ta evituar presionin nga Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), ndërsa udhëheqësi i BDI-së i ka bërë thirrje shqiptarëve etnikë për t'i dhënë partisë së tij 25 ulëse, për të pasur ndikim më të madh në qeveri.
- Kodi zgjedhor i obligon mediat e transmetuara ta mbulojnë fushatën në mënyrë të drejtë, të baraspeshuar dhe të paanshme. Të gjithë kandidatët presidencialë kanë të drejtë të raportimit të barabartë, ndërsa pjesëmarrësit e zgjedhjeve parlamentare mbuloohen në bazë proporcionale, varësisht nga numri i listave të parashtruara për kandidatë. Dispozitat e reja në Kodin zgjedhor i theksojnë kërkesat e detajuara për edicionet informative të transmetuesit publik, Radiotelevizionit Maqedonas (RTM) gjatë fushatës zgjedhore.
- Korniza ligjore e cila e përcakton financimin e partive dhe fushatës është ndryshuar në janar

2014, për ta trajtuar shumicën e çështjeve të ngritura pas zgjedhjeve të kaluara, përfshirë edhe kufirin për donacionet.

## II. HYRJE

Pas ftesës nga Ministria për Punë të Jashtme, OSBE Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) e themeloi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 10 mars. MVZ i OSBE/ODIHR udhëhiqet nga Ambasadori Geert-Hinrich Ahrens dhe përbëhet nga 11 ekspertë të vendosur në Shkup, si dhe 20 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin. Anëtarët e Misionit vijnë nga 17 shtete të ndryshme pjesëmarrëse të OSBE-së. Shteteve-pjesëmarrëse i është kërkuar delegimi i 300 vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e votimit të hershëm, hapjes, numërimit dhe shpalljes së rezultateve në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 27 prillit, si dhe rrethit të dytë të mundshëm të zgjedhjeve presidenciale. Për shkak të mungesës së delegimit të mjaftueshëm të vëzhguesve afatshkurtër, OSBE/ODIHR nuk mund ta realizojë vëzhgimin e paraparë sistematik dhe të gjerë të veprimeve në ditën e votimit, për zgjedhjet presidenciale më 13 prill.

## III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, zgjedhjet presidenciale do të mbahen më 13 prill, ndërsa rrethi i dytë i mundshëm është paraparë për 27 prill. Parlamenti është shpërndarë më 5 mars sipas nismës së Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) dhe zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë përcaktuar për 27 prill. Ndonëse opozita e ka mbështetur nismën për zgjedhje të parakohshme, ata e kanë cilësuar këtë vendim si arsyetim i partive qeverisëse për thirrjen e zgjedhjeve, në periudhë kur hulumtimet e opinionit publik janë në favor të tyre për të fituar një mandat tjetër katërvjeçar.

Presidenti aktual Gjorge Ivanov, i ndërlidhur me partinë qeverisëse Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), do të garojë për mandat të dytë. Në zgjedhjet vijuese, ai do të sfidohet nga Stevo Pendarovski, i ndërlidhur me Lidhjen Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) në opozitë; Iljaz Halimi, kandidati i vetëm etnik shqiptar, i ndërlidhur me Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH); si dhe nga Zoran Popovski, i ndërlidhur me Opsionin qytetar për Maqedoninë (GROM) që është themeluar para ca kohësh. Të gjitha partitë më të mëdha politike kanë paralajmëruar pjesëmarrje në zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Fillimisht, BDI ka shpallur që do t'i bojkotojë zgjedhjet presidenciale dhe ka bërë thirrje për zgjedhje të parakohshme parlamentare, duke cekur që partneri i koalicionit VMRO-DPMNE i ka injoruar thirrjet e saj për propozim të kandidatit konsensual, që do t'i përfaqësojë dy bashkësitë – maqedonasit etnikë dhe shqiptarët etnikë. Udhëheqësi i partisë, Ali Ahmeti, më pas ka cekur që do t'i inkurajojnë shqiptarët etnikë të përmbahen nga votimi, për ta parandaluar përmbushjen e kriterit për dalje të 40% në rrethin e dytë të votimit, që e shkakton dështimin e zgjedhjeve presidenciale.

## IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet përcaktohen kryesisht nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor, që është ndryshuar për here të fundit më 24 janar 2014.<sup>1</sup> Kjo është përpjekje për trajtimin e pjesës më të madhe të rekomandimeve paraprake të OSBE/ODIHR.<sup>2</sup> Këto amendamente i përfshijnë masat mbrojtëse për ndarjen e partisë

<sup>1</sup> Kodi i Komisionit të Venedikut për praktikën e mire në çështjet zgjedhore rekomandon që “elementet thelbësore të ligjit zgjedhor... nuk duhet të hapen për ndryshime në periudhë më të shkurtër se një vit para zgjedhjeve”.  
<http://www.venice.coe.int/webforms/documents/CDL-AD%282002%29023rev-e.aspx>

<sup>2</sup> Raportet paraprake të OSBE/ODIHR gjenden në <http://osce.org/odihr/elections/fyrom>.

dhe shtetit; qartësimin e rregullativës për financimin e partisë dhe fushatës, si dhe kërkesa më të fuqishme për raportim; të drejtën e partive politike për shikimin e listës zgjedhore dhe për të kërkuar ndryshime; afate të reja për gjykatat për të vendosur mbi shkeljet e mediave, si dhe për përcjelljen e lëndëve në gjykata nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

Megjithatë, ka disa çështje që mbetin pa u trajtuar, veçanërisht kufizimet restriktive lidhur me përkufizimin dhe kohëzgjatjen e fushatës, pabarazia mes votave jashtë dhe atyre brenda vendit, pragu i 50% për t'i fituar zgjedhjet presidenciale në rrethin e parë dhe 40% e daljes së votuesve në rrethin e dytë, si dhe mungesa e auditimit të raporteve për financimin e fushatës para zgjedhjeve dhe sanksionimin për mos-parashtrimin e tyre.

Presidenti zgjidhet në një njësi zgjedhore me votë të përgjithshme dhe të drejtpërdrejtë, përmes votimit të fshehtë për mandat pesëvjeçar, sipas sistemit të shumicës. Presidenti nuk mund të zgjidhet për këtë pozitë më tepër se dy herë. Për zgjidhje në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë më tepër se 50% të numrit total të votuesve të regjistruar. Në të kundërtën, brenda dy javëve mbahet rrethi i dytë mes dy kandidatëve të cilët kanë marrë më së shumti vota në rrethin e parë. Në rrethin e dytë fiton kandidati që e fiton shumicën e votave, me kusht që dalja e votuesve të jetë mbi 40%. Përndryshe, përsëritet tërë procesi.

Parlamenti zgjidhet për mandat katërvjeçar. Prej 123 deputetëve, 120 zgjidhen sipas sistemit të përfaqësimit proporcional, në 6 njësi zgjedhore. Tjerët zgjidhen me sistemin e shumicës në tre njësi jashtë vendit (Evropë dhe Afrikë, Amerikë veriore dhe jugore, Australi dhe Azi). Nuk ka prag për garën proporcionale, por kandidatët jashtë vendit duhet të fitojnë të paktën 2% të votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore për të qenë të zgjedhur. Në zgjedhjet e kaluara, numri i vogël i votuesve të regjistruar dhe që votojnë jashtë vendit e ka ngritur çështjen e barazisë së votave brenda dhe jashtë vendit.

## V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet administrohen nga administrata zgjedhore në tre nivele: KSHZ, 80 komisionet komunale zgjedhore (KKZ), 3,480 këshillat zgjedhore (KZ) brenda vendit, si dhe 34 KZ në përfaqësitë diplomatike-konsullore (PDK).

KSHZ është trup i përhershëm, përgjegjës për realizimin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Përbëhet prej shtatë anëtarëve të emëruar nga parlamenti, me mandat katërvjeçar. Kryetari i KSHZ-së dhe dy anëtarë propozohen nga partitë opozitare, ndërsa zëvendëskryetari dhe tre anëtarë nga partitë qeverisëse.<sup>3</sup> Sesionet e KSHZ-së janë të hapura për vëzhguesit e akredituar dhe mediat.

Në përgjithësi, KSHZ i ka respektuar afatet ligjore deri tani dhe sesionet e vijuar nga MVZ i OSBE/ODIHR janë realizuar në mënyrë profesionale. Si që kërkohet me ligj, procesverbalet e çdo sesioni janë publikuar në ueb-faqen e KSHZ-së brenda 48 orëve. Por, sesionet e KSHZ-së në të cilat është vendosur për kërkesat e BDI-së dhe LSDM-së për ndryshimet e listave zgjedhore, kanë qenë të tensionuara dhe votimi ka qenë përgjatë linjave partiake (lexoni pjesën Regjistrimi i votuesve).

KKZ-të janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në komunat gjegjëse. Ato i emërojnë KZ-të dhe e mbikëqyrin punën e tyre. KZ-të janë përgjegjës për mbarëvajtjen e zgjedhjeve në ditën e zgjedhjeve. Çdo KKZ dhe KZ përbëhet nga kryetari, katër anëtarë dhe zëvendësit e tyre. Anëtarët e

---

<sup>3</sup> Kryetari i KSHZ-së është emëruar më 21 nëntor 2013. Kryetari i mëparshëm është dorëhequr më 18 tetor 2013 për arsye personale.

KKZ-së përzgjidhen sipas zgjedhjes së rastit nga të punësuarit e administratës lokale. KZ-të krijohen përmes modelit të përzier profesional-politik, ku një anëtar propozohet nga partitë politike qeverisëse, një nga partitë opozitare dhe tre anëtarë sipas zgjedhjes së rastit nga nëpunësit publikë. Në mënyrë të ngjashme formohen KZ-të për vendvotimet në PDK-të e hapura jashtë vendit, ku kryetari propozohet nga diplomatët e punësuar në PDK-në gjegjëse.

Në pajtim me praktikën e mirë ndërkombëtare dhe duke i vijuar rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR, Kodi zgjedhor është ndryshuar me dispozitën ku kërkohet që kryetarët e KZ-ve të kenë diplomë universitare, ndërsa anëtarët të kenë arsim të mesëm.<sup>4</sup> MVZ i OSBE/ODIHR është informuar nga disa KKZ që kjo ka krijuar ca vështirësi gjatë identifikimit të numrit të nevojshëm të personave të kualifikuar. Janë realizuar dy trajnime nga KSHZ për KKZ-të më 5 dhe 26 mars në mbarë vendin. Janë respektuar dispozitat e Kodit zgjedhor për përfaqësim të barabartë etnik dhe gjinor në administratën zgjedhore.

## VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Në listën zgjedhore për votim në vend regjistrohen qytetarët me moshë të mbushur 18 vjeçare në ditën e zgjedhjeve, që kanë vendbanim në njësinë gjegjëse zgjedhore, kanë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme biometrike dhe të cilëve nuk ju është marrë aftësia e veprimit juridik me vendim gjyqësor. Për të votuar jashtë, votuesit duhet të regjistrohen në PDK-në gjegjëse, si persona të cilët jetojnë ose punojnë përkohësisht jashtë vendit. Ndonëse Kushtetuta nuk kërkon që personi të ketë vendbanim në vend për të qenë votues, Kodi zgjedhor përcakton që vetëm personat me vendbanim në vend mund të përfshihen në listën zgjedhore.

Sipas Kodit zgjedhor, KSHZ është përgjegjëse për listat zgjedhore, në bazë të informatave të cilat i marrin nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e cila i mban regjistrat e shtetësisë dhe vendbanimit dhe i lëshon letërnjoftimet dhe pasaportat biometrike. Ministria e Drejtësisë ia siguron informatat KSHZ-së për personat të cilët kanë ndërruar jetë.

Amendamentet e Kodit zgjedhor ia mundësojnë partive politike ta sfidojnë listën zgjedhore, në bazë të kopjeve të cilat i jepen atyre nga KSHZ. Në bazë të kësaj dispozite janë parashtruar dy kundërshtime në KSHZ, një nga BDI dhe tjetra nga LSDM, duke e kërkuar ndryshimin e 453, gjegjësisht 14,492 emrave.<sup>5</sup> KSHZ ka kërkuar nga MPB që t'i trajtojë këto kërkesa, por MPB është përgjigjur që i ka siguruar informatat që kërkohen nga ligji, andaj përgjegjësia tani i takon KSHZ-së. Rrjedhimisht, KSHZ i ka refuzuar këto kërkesa duke votuar përgjatë linjave partiake.<sup>6</sup> LSDM dhe BDI kanë ngritur padi në Gjykatën Administrative, e cila i ka refuzuar kundërshtimet në bazë të dokumenteve të siguruara nga MPB. MPB nuk ka realizuar asnjë hetim të pavarur të çështjes.

Ekzistojnë afate të ndryshme për mbylljen e listës zgjedhore për zgjedhjet presidenciale dhe ato parlamentare. Kjo do të rezultojë me hartimin e dy listave të ndryshme zgjedhore. Sipas KSHZ-së, janë regjistruar 1,779, 572 qytetarë për votim në zgjedhjet presidenciale, prej të cilëve 8,332 votues me banim dhe punë të përkohshme jashtë vendit, të regjistruar për votim jashtë vendit. Gjatë

<sup>4</sup> Në raportin final për zgjedhjet lokale 2013, OSBE/ODIHR ka rekomanduar që “Duhet të konsiderohet sigurimi i trajnimeve më të shpeshta dhe më të detajuara për anëtarët e KZ-ve”. Kodi i Komisionit të Venedikut për praktikën e mire në çështjet zgjedhore rekomandon që anëtarët e administratës zgjedhore “duhet të jenë të kualifikuar për çështjet zgjedhore” dhe që “duhet të trajnohen me trajnime standarde”.

<sup>5</sup> BDI e ka kërkuar fshirjen e 453 personave të regjistruar në Ambasadën në Tiranë. SDSM ka sfiduar 14,492 emra, përfshirë edhe grupe njerëzish të regjistruar në adresë të njëjtë, 991 persona të vdekur dhe persona për të cilët është pohuar se kanë ndryshuar adresë ose janë larguar nga vendi.

<sup>6</sup> Gjatë sesionit të KSHZ-së në periudhën 20-21 mars, tre anëtarët nga VMRO-DPMNE kanë votuar kundër dy kundërshtimeve, ndërsa i propozuari nga PDSH ka qenë i përmbajtur.

periudhës së shikimit publik, rreth 74,400 persona e kanë kontrolluar regjistrimin e tyre në listën zgjedhore për zgjedhjet presidenciale në zyrat rajonale të KSHZ-së, ndërsa rreth 115,400 e kanë kryer kontrollimin përmes internetit. Lista zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mbyllet më 9 prill.

## VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

E drejta për kandidaturë presidenciale i jepet të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, të cilët kanë të paktën 40 vjet moshe dhe kanë jetuar në vend të paktën 10 vjet gjatë 15 viteve të fundit. Propozimi për president duhet të mbështetet nga 10,000 votues ose 30 deputetë. Nënshkrimet për mbështetje duhet të mbledhen para përfaqësuesve të KSHZ-së në ndonjërin prej 34 zyrave rajonale të saj. KSHZ ka vendosur të hapë zyra rajonale në çdonjërin prej 80 komunave, për ta shpejtuar procesin. Dy të propozuar, të cilët nuk i kanë mbledhur nënshkrimet e nevojshme kanë pohuar se obligimi për dhënien e nënshkrimeve para zyrtarit shtetëror ka qenë frikësues dhe numri i nënshkrimeve të nevojshme ka qenë shumë i lartë. Asnjëri nuk ka parashtruar kundërshtim zyrtar.<sup>7</sup>

Në zgjedhjet parlamentare mund të garojnë kandidatët e propozuar nga partitë politike, koalicionet e partive politike ose kandidatët e pavarur të propozuar nga grupet e votuesve. Propozimet duhet t'i parashtrohen KSHZ-së deri më 29 mars. Çdo qytetar me të drejtë vote ka të drejtë të garojë si kandidat në zgjedhjet parlamentare. Ata që vuajnë dënim me burg prej të paktën gjashtë muajve për ndonjë vepër penale nuk mund të garojnë. Për ta nxitur pjesëmarrjen e femrave, Kodi zgjedhor përcakton që të paktën një prej tre vendeve sipas radhitjes në listën e kandidatëve, duhet të rezervohen për gjininë më pak të përfaqësuar.

## VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Fushata për zgjedhjet presidenciale ka filluar zyrtarisht më 24 mars, ndërsa fushata për zgjedhjet e parakohshme parlamentare fillon më 5 prill. Kandidatët kanë filluar të takohen me qytetarët gjatë vizitave në mbarë vendin para datave të cekura.<sup>8</sup> Në mesin e muajit mars, Presidenti Ivanov ka vizituar 70 qytete dhe fshatra. Më 23 mars, ai e ka prezantuar programin e tij zgjedhor. Më 16 mars, z. Pendarovski ka mbajtur tubim me 50 persona në Prilep. Më 21 mars, PDSH ka mbajtur miting me 350 persona në Gostivar për promovim dhe për t'i bërë thirrje shqiptarëve etnikë për ta votuar z. Halimin. Për më tepër, Kryetari dhe Kryeministri, fushata parlamentare e të cilit nuk fillon deri më 5 prill, i kanë promovuar publikisht raportet për të arriturat gjatë mandatit të VMRO-DPMNE-së. Më 22 mars, edhe BDI e ka prezantuar raportin për të arriturat që nga viti 2011.

Të gjithë katër kandidatët presidencialë dhe partitë politike me të cilat janë ndërlidhur kanë mbajtur tubime më 24 mars, për hapjen zyrtare të fushatës. VMRO-DPMNE ka mbajtur miting në Ohër, ndërsa LSDM, GROM dhe PDSH në Shkup. BDI ka mbajtur miting në Kërçovë, duke i bërë thirrje mbështetësve për të mos votuar, për arsye se shtetit i duhet kandidat konsensual për kryetar, i pranueshëm për të gjithë qytetarët.

Pritet që fushata të fokusohet në ekonomi, punësim, arsim dhe reforma sociale. Një çështje tjetër kyçe është perspektiva e integritimit euro-atlantik të vendit, synim i të gjithë kandidatëve presidencialë dhe udhëheqësve të partive kryesore. Fillimi i fushatës tashmë është shënuar me retorikë ndarëse etnike. Kryeministri Gruevski i ka bërë thirrje maqedonasve etnikë që t'i japin VMRO-DPMNE-së

---

<sup>7</sup> Stojançe Angelov, Kryetari i *Dostoinstvo (Dinjiteti)* dhe Biljana Vankovska, kandidate e pavarur.

<sup>8</sup> Periudha e fushatës fillon 20 ditë para ditës së votimit. Meqë fushata për zgjedhjet parlamentare përputhet me periudhën e heshtjes për zgjedhjet presidenciale, KSHZ njëzëri ka vendosur që ta fillojë fushatën parlamentare dy ditë më herët, me ndërprerje dyditore gjatë heshtjes zgjedhore për zgjedhjet presidenciale.

shumicë të qartë prej 62 ulëseve, për ta evituar presionin nga BDI, ndërsa z. Ahmeti i ka bërë thirrje shqiptarëve etnikë për t'i dhënë partisë së tij 25 ulëse, për të pasur ndikim më të madh në qeveri.

Disa udhëheqës të partive e kanë informuar MVZ të OSBE/ODIHR që presin probleme të frikësimit dhe presionit nga autoritetet shtetërore gjatë fushatës. Akuzat për korrupsion dhe sulmet personale po shkëmbehen edhe para fillimit zyrtar të fushatës së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ndërmjet dy partive etnike maqedonase (VMRO-DPMNE dhe LSDM), si dhe mes dy partive kryesore të shqiptarëve etnikë (BDI dhe PDSH).

## IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Korniza ligjore me të cilat rregullohet financimi partiak dhe i fushatës është ndryshuar në janar 2014, për të trajtuar një sërë çështjesh të ngritura pas zgjedhjeve të fundit.<sup>9</sup> Garuesit obligohen të marrin numër të vetëm tatimor dhe të hapin llogari të veçantë bankare. Të gjitha transaksionet financiare të lidhura me fushatën duhet të realizohen përmes kësaj llogarie. Secili pjesëmarrës në zgjedhje nuk mund të shpenzojë më tepër se 180 MKD (rreth 3 EUR) për votues të regjistruar, gjegjësisht shumë totale prej rreth 5 milionë EUR. Shpenzimet e pjesëmarrësve për zgjedhje kompensohen nga buxheti shtetëror me nga 15 MKD (rreth 0.25 EUR) për çdo votë të fituar, me kusht që të kenë marrë të paktën 1.5% nga totali i votave të hedhura.

Përkitazi me rekomandimet e OSBE/ODIHR, amendamentet e fundit të Ligjit për financimin e partive politike kanë promovuar limite të reja për dhënien e donacioneve. Personat e përshtatshëm privatë mund të japin deri në ekuivalentin e 5,000 EUR në valutën nacionale, ndërsa limiti për personat juridikë është 50,000 EUR. Ndalohen donacionet anonime, donacionet nga burimet shtetërore, publike, komunale ose të huaja, shoqatat e qytetarëve dhe bashkësitë fetare.

Garuesit e zgjedhjeve duhet të parashtrajnë katër raporte të detajuara financiare, në formularin e siguruar nga Ministria e Financave, përfshirë edhe raportin para dy ditëve të zgjedhjeve. Raportet duhet t'i parashtrihen KSHZ-së, Entit Shtetëror për Revizion dhe KSHPK-së. Enti Shtetëror për Revizion i shqyrton raportet finale brenda 60 ditëve nga parashtrimi i tyre. Raportet financiare parazgjedhore nuk i nënshtrohen auditimit dhe nuk ka sanksione për mos parashtrimin e tyre.

## X. MEDIAT

Kodi zgjedhor i obligon mediat e transmetuara ta mbulojnë fushatën në mënyrë të drejtë, të baraspeshuar dhe të paanshme. Të gjithë kandidatët presidencialë kanë të drejtë të raportimit të barabartë, ndërsa pjesëmarrësit e zgjedhjeve parlamentare mbulohen në bazë proporcionale, varësisht nga numri i listave të dorëzuara.

Dispozitat e reja në Kodin Zgjedhor i theksojnë kërkesat e detajuara për edicionet informative të transmetuesit publik, Radiotelevizionit Maqedonas (RTM) gjatë fushatës zgjedhore: një e treta e edicionit informativ duhet t'i përkushtohet ngjarjeve lokale dhe ndërkombëtare, një e treta për aktivitetet e partive politike qeverisëse, ndërsa një e treta për aktivitetet e partive në opozitë.<sup>10</sup> Partive politike të cilat nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe nuk përfaqësohen në parlament, nuk ju takon kohë raportimi gjatë këtyre edicioneve.<sup>11</sup> RTM obligohet t'i

---

<sup>9</sup> Ligji për financimin e partive politike është ndryshuar më 24 janar 2014.

<sup>10</sup> Hapësira kohore do t'i jepet partive qeverisëse dhe opozitare varësisht nga rezultatet e zgjedhjeve të fundit parlamentare.

<sup>11</sup> Disa bashkëbisedues nga RTM i kanë përshkruar këto dispozita si të paqarta, veçanërisht kur merret parasysh përputhja e dy fushatave. Mosrespektimi i këtyre kërkesave nga RTM mund të rezultojë me shkarkimin e Drejtorit gjeneral të RTM-së.

jep periudhë transmetimi falas të gjithë garuesve mes orës 16:00 dhe 23:00. Më 21 mars, RTM ka vendosur që secilit kandidat presidencial t'i jep 15 minuta të transmetimit falas për prezantimet gjatë javës para ditës së zgjedhjeve. Gjatë fushatës, transmetuesit privatë mund të shesin deri në 12 minuta në ore për reklama të paguara politike, ku maksimumi për një garues zgjedhor është 8 minuta brenda një ore.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA) është trupi kryesor rregullator për mediat, përgjegjës për realizimin e monitorimit të mediave dhe ngritjes së procedurave kundërvajtëse, nëse identifikohen shkelje. Më 21 mars, ASHMAA i ka miratuar "Specifikat e metodologjisë për monitorimin e procesit zgjedhor 2014". Ndonëse pa peshë të obligimit juridik, ky dokument i qartëson kërkesat ligjore për raportimin e mediave mbi fushatën, përfshirë edhe periudhën e përputhjes së fushatës presidenciale me atë parlamentare. ASHMAA ka iniciuar dy procedura kundërvajtëse kundër *TVM-2* dhe *TV Sitel* për mospublikimin e të gjitha informatave që kërkohen me ligj gjatë publikimit të hulumtimit të mendimit publik, si dhe dy kundër *TV Boem* për emetimin e reklamave të paguara politike para fillimit zyrtar të fushatës.

Më 11 mars, Seksioni për monitorimin e mediave në kuadër të MVZ të OSBE/ODIHR, ka filluar me monitorimin cilësor dhe sasior të tetë stacioneve televizive dhe katër gazetave ditore.<sup>12</sup> Monitorimi do t'i përfshijë fushatat presidenciale dhe parlamentare, si dhe periudhën para fillimit zyrtar të fushatës.

## **XI. KUNDËRSHTIMET DHE PADITË**

Korniza e kundërshtimeve dhe padive për dy zgjedhjet e siguron mbrojtjen e të drejtës së votës në çdo fazë të procesit zgjedhor. Kundërshtimet mund të parashtrihen nga kandidatët, parashtruesit e listave të kandidatëve, si dhe votuesit në raste të kufizuara. Kundërshtimet shqyrtohen nga KSHZ, gjykatat themelore, gjykatat e apelit, si dhe Gjykata Administrative. Ekzistojnë korniza të ndryshme kohore për parashtrimin dhe vendosjen ndaj llojeve të ndryshme të kundërshtimeve, prej 24 orëve deri më 7 ditë. KSHZ nuk mund të shqiptojë sanksione, por duhet t'ia përcjellë rastet gjykatave kompetente për ndërmarrjen e veprimeve. Nuk ka afate brenda të cilave gjykatat duhet të vendosin për këto raste.

Më 25 mars, KSHZ ka shqyrtuar dy kundërshtime të parashtruara nga LSDM për fillimin e pretenduar të parakohshëm të fushatës. KSHZ e ka aprovuar kundërshtimin e parë ku LSDM ka pohuar se Presidenti Ivanov është angazhuar në fushatë të parakohshme më 14 mars.<sup>13</sup> Në kundërshtimin e dytë është pohuar fillimi i parakohshëm i fushatës nga VMRO-DPMNE, përmes tubimit publik më 16 mars, ku janë promovuar të arriturat e qeverisë; kjo është refuzuar me arsyetimin që listat e kandidatëve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare nuk kanë qenë të konfirmuara.

## **XII. VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË**

Kodi zgjedhor e mundëson vëzhgimin e zgjedhjeve nga vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë. Grupet qytetare të vëzhgimit duhet të regjistrohen të paktën një vit para ditës së zgjedhjeve dhe duhet ta kenë përfshirë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në statutin e tyre. Organizatat qytetare MOST dhe CIVIL planifikojnë të dërgojnë vëzhgues. Përveç kësaj, secili parashtrues i listës së kandidatëve ka të

---

<sup>12</sup> Televizionet: *RTM-1*, *RTM -2*, *Sitel*, *Kanal 5*, *Alsat-M*, *Telma*, *Alfa* dhe *Vesti 24*. Gazetat: *Dnevnik*, *Nova Makedonija*, *Sloboden Pecat* dhe *Koha*.

<sup>13</sup> Neni 69a i Kodit zgjedhor e përkufizon fushatën si aktivitet për promovimin e kandidatit të regjistruar gjatë periudhës së fushatës zyrtare.

drejtë të emërojë përfaqësues të autorizuar dhe zëvendës, për përcjelljen e punës së administratës zgjedhore, përfshirë edhe në ditën e zgjedhjeve.

### **XIII. AKTIVITETET E MISIONIT**

MVZ i OSBE/ODIHR ka filluar me punë më 10 mars. Shefi i Misionit është takuar me Presidentin, Kryeministrin, KSHZ-në dhe zyrtarë tjerë të lartë, katër kandidatët presidencialë, partitë politike dhe përfaqësuesit diplomatikë. MVZ ka krijuar kontakte edhe me përfaqësuesit e mediave, shoqërinë civile dhe palët tjera të përfshira në zgjedhje. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës planifikon të dërgojë delegacione të vëzhguesve për dy zgjedhjet, ndërsa Asambleja Parlamentare e OSBE-së do të dërgojë delegacion për vëzhgimin e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 27 prill.

*Versioni në gjuhën angleze është raporti i vetëm zyrtar.  
Sigurohen përkthime jozyrtare në gjuhën shqipe dhe maqedonase.*